



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura e III-të

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion;

Mbledhja nr.19/2008;

Më 16.09.2008, në ora 11:00;

Ndërtesa e Kuvendit, Salla C-203;

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani, Et'hem Çeku, Haki Shatri, Kaqusha Jaashari, Fatmir Rexhepi, Berim Ramosaj, Múfera Şinik, Safete Hadergjonaj, Zef Morina dhe Sala Berisha – Shala;

Mungoj: Slobodan Petroviq;

Përcjellës prezent: Nora Sahatçiu nga UNDP/UNKT, Behar Xharra nga UNPD, Fatmir Haxholli UNDP, Nol Buzhala nga MTI-ja – ANVM-ja, Haxhi Gashi nga USAID, Blerina Uka nga NDI dhe Valmir Ismajli nga KDI-ja;

Nga zyra mbështetëse: Hasan Tahiri, Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Nurije Morina;

Mbledhjen e drejtoi: Myzejene Selmani – Kryetare e Komisionit;

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhja e kaluar datë 09 shtator 2008;
3. Shqyrtimi i kërkesës së ZRRE-së, për ndryshimin e tri rregulloreve të saj;
4. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë për emërimin e anëtarve të Komisionit të Konkurrencës;
5. Shqyrtimi i kërkesës së Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Rregullatorit të Energjisë;
6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Projektligjit për Ndryshim Plotësimin e Ligjit për Mbështetje të NVM-ve;
7. Të ndryshme;

I. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

Kryetarja – i njoftoi anëtarët e Komisionit që në mbledhje janë prezent zyrtar nga UNDP/UNKT, mirëpo edhe pse nuk ishte paraparë në rend dite, kërkoi mirëkuptim nga anëtarët e Komisionit që ti ipet fjala, znj. Nora Sahatçiu, koordinatore e projektit për Objektivat e Zhvillimore të Mijëvjeçarit në Kuvend, për një fjalë rasti.

Nora Sahatçiu (UNDP/UNKT) – i falënderoj anëtarët e Komisionit për pritjen dhe i informoj për Projektin Objektivat e Zhvillimore të Mijëvjeçarit (OZhM) në Kuvend, i cili ka për qëllim përkushtimin e Kuvendit të Kosovës për arritjen e OZhM-ve, si dhe Strategjinë për Monitorimin e OZhM-ve dhe Agjendës së BE-së, për Përfshirje Sociale në të gjitha aktivitetet e Kuvendit.

II. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhja e kaluar datë 09 shtator 2008;

Procesverbali nga mbledhja e datës 09 shtator 2008, u miratua pa vërejtje.

III. Shqyrtimi i kërkesës së ZRRE-së, për ndryshimin e tri rregulloreve të saj;

Berim Ramosaj – theksoj se është kompetenc e vet institucionve të pavarura, që të rregullojnë fushën e tyre të brendshme. Mirëpo në fund shtoj se si Komision duhet të jemi të vëmendshëm se si po rrjedh situata në mes ZRRE-së dhe MEM-it.

Haki Shatri – tha se ZRRE-ja, është institucion i pavarur, dhe Komisioni mundet vetëm të rekomandojë se e mbështet verzionin e rregulloreve.

Et'hem Çeku – tha se institucionet e pavarura siç janë ZRRE-ja dhe KPMM-ja, janë institucione të rëndësishme për bartjen e zhvillimit, andaj duhet të ruhet autonomia e këtyre institucioneve.

Safete Hadergjonaj – theksoj se e kupton qëllimin e mirë të këtij institucioni, por afati ka kaluar për komentet që mund ti jap Komisioni, për shkak të pushimeve që ka pasur Kuvendi.

Pas debatit të gjerë, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Duke kontribuar në ruajtjen e pavarsisë të Agjencive të pavarura publike, në këtë rast të ZRRE-së, Komisioni mbështet iniciativën e rregullimit të brendshëm më akte sekondare ligjore të kësaj agjencie;

IV. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë për emërimin e anëtarve të Komisionit të Konkurrencës;

Kryetarja – kërkoi nga anëtarët e Komisionit që të formohet një Grup Punues për të proceduar këtë çështje sipas ligjit.

Haki Shatri – theksoj se Komisioni mund të paraqet vërejtjet e tij për individet e propozuar dhe pastaj të votohen në seancë plenare.

Safete Hadergjonaj – përkrahu mendimin e z.Shatri, mirëpo theksoj se është detyrë ligjore që Komisioni më i përzgjedh së cilët kandidat i plotësojnë kriterët, për të qënë anëtarë të Bordit të Konkurrencës.

Zef Morina – theksoj se Ligji për Konkurrencën, decidivisht neni 25 përcakton dhe obligon Komisionin tonë, që të bejë intervistimin e tyre dhe në fund t’ia propozoj Kuvendit për miratim.

Sala Berisha – Shala – u pajtua më z.Morina, dhe kërkoj që Komisioni të formoj një Grup Punues, në menyrë që të zbatohet ligji më përpikëmeri.

Fatmir Rexhepi – tha se kjo kërkon një punë dhe angazhim të madh dhe propozoj që të kjo çështje të debatohet në një takim tjetër.

Pas këtij debati, Komisioni erdh në përfundim që Grupi Punues, të jetë në këtë përberje:

1. Myzejene Selmani;
2. Sala Berisha – Shala;
3. Fatmir Rexhepi;
4. Berim Ramosaj dhe
5. Múfera Şinik;

V. Shqyrtimi i kërkesës së Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Rregullatorit të Energjisë;

Kryetarja – për shkak të ekspertizës së tyre kërkoj nga z.Çeku dhe z.Rexhepi, që të japim komentet e tyre në lidhje më këtë kërkesë.

Et’hem Çeku – theksoj se Ligji përcakton qartë se si behet zgjedhja e anëtarve të Bordit të ZRRE - së, dhe kërkoj që vetem të zbatohet ajo procedurë e përcaktuar më Ligjin për ZRRE - në.

Fatmir Rexhepi – ishte i mendimit që Komisioni të pakten të nxjerrë një konkluzion dhe t’ia paraqes Kuvendit në seancë plenare.

Safete Hadergjonaj – theksoj se dokumentacioni i ofruar për këta dy anëtarë, më vetem më nga një kopje të CV-së, është e pamjaftueshme dhe nuk të jap një pasqyrë reale për kualifikimin e tyre. Dhe poashtu përkrahu idenë e z.Rexhepi, që edhe Komisioni ynë mund të jap një sygjërim për kandidatet e porpozuar.

Berim Ramosaj – tha se Komisioni ynë mund të jap vetem vërejtje parimore pa u lëshuar në detaje tjera.

Pas debatit të gjerë, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Për shkak të mangesive substanciale në dokumentacionin e ofruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, kërkohet që të ipet informacion më të detajuar për kandidatet e propozuar, duke përfshirë këtu dokumentacionin origjinal për kualifikimet dhe ekspertizen e tyre;

VI. Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Projektligjit për Ndryshim Plotësimin e Ligjit për Mbështetje të NVM-ve;

Kryetarja – i'a dha fjalën znj.Hadergjonaj, për raportim për këtë projektligj, pasi që është referuese e Grupit Punues.

Safete Hadergjonaj – në fillim të diskutimit shprehu keqardhjen e saj, për shkak se çështja e këtij raporti u zgjat shumë, mirëpo ajo theksoj se është në të mirën e interesit të përgjithshëm dhe ka ndjer një obligim për evitimin e atyre lëshimeve, për shkak së është referuese e këtij projektligji. Pastaj, ajo paraqiti propozimet që duhen bërë në Raport, si më poshtë:

1. Të shënohet aty ku nuk është shënuar: përkrahen nga Komisioni amendamentet e propozuara nga dep.Sala Berisha – Shala;
2. Të vendoset pika “m” pas amendamentit 6 dmth pas pikës “c”;
3. Të shtohet amendamenti i ri për shkak të rrethanave të reja të fshihet nga Raporti “PSSP-ja” dhe të vendoset nga rregullativa e ekzekutivit tek neni 11;
4. Të amendamenti 13 të futet pika 2 e nenit 11;
5. Të përfshihen Referencat e Raportit të datës 15.04.2008;

Pas propozimeve të referueses znj.Hadergjonaj, për Raportin me amendamente të Projektligjit për Ndryshim Plotësimin e Ligjit për Mbështetje të NVM-ve, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Miratohen amendamentet e propozuara nga referuesja znj.Hadergjonaj, për Raportin me amendamente të Projektligjit për Ndryshim Plotësimin e Ligjit për Mbështetje të NVM-ve;

VII. Të ndryshme;

Kryearja – theksoj së për mbledhjen e ardhshme duhet të shtjellojm çështjen e tri projektligjeve të kthyer nga PSSP-ja, dhe të filloj punën Grupi Punues për Monitorimin e Ligjit për Rrugët, ku këto pika të lartëcekura të përfshihen si pika qendrore të rendit të ditës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00;

Kryetare e Komisionit:
Myzejene Selmani